

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Në trevjetorin e rënies, familja e Afrim Bunjakut mban pritje përkujtimore
ADRESA	https://albeu.com/kosove/ne-trevjetorin-e-renies-familja-e-afrim-bunjakut-mban-pritje-pe-rkujtimore/1025205/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 08:24:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 08:22:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9abb1eed1820ff3d1214c3d9859d33872be16ba655dc2f3516ed17e55f5a612f
TEKSTI	ee589a05a040b5fcc6b8ccf4782f53e21c030ed6628957ecb1330c7a1ab33e79
PAMJA	7eaa1418b8b2ec220b42bbe5cafeddeb1130ebe7d547f8a4ed0bd2deb3489c08

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5f203819ae48c6fb63f5b089e85876b6bd1c46b282f3b6238ef66d035067f945
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a6b20a4f7bca7d38b85ed38d229f05609a1ca606edde02ba3c9e62d673a221c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5f203819ae48c6fb63f5b089e85876b6bd1c46b282f3b6238ef66d035067f945>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Në trevjetorin e rënies, familja e Afrim Bunjakut mban pritje përkujtimore



Në shenjë nderimi për rreshterin e Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili humbi jetën më 24 shtator 2023 gjatë një sulmi terrorist në Banjskë të Zveçanit, familja e tij ka organizuar një pritje përkujtimore me rastin e trevjetorit të rënies.

Të afërm, miq, familjarë dhe qytetarë të shumtë kanë filluar të dynden për të nderuar kujtimin e Bunjakut, i cili ra në krye të detyrës gjatë përplasjeve me një grup të armatosur që kishte sulmuar forcat e rendit në pjesën veriore të vendit.

Sulmi i 24 shtatorit 2023 shënoi një nga ngjarjet më të rënda në veriun e Kosovës që nga përfundimi i luftës. Një grup i armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në Banjskë, duke i marrë jetën rreshterit Afrim Bunjaku dhe duke plagosur dy policë të tjerë.

Gjatë operacionit të forcave të rendit, tre anëtarë të grupit u vranë dhe tre të tjerë u vunë në pranga. Në afërsi të Manastirit të Banjskës, autoritetet zbuluan një sasi të konsiderueshme armatimi, pajisje të karakterit ushtarak dhe dokumentacioni që, sipas institucioneve kosovare, dëshmon përgatitjen e sulmit.

Vetëm dy ditë pas ngjarjes, ministri i Punëve të Brendshme Xhelal Sveçla bëri publike pamjet filmike ku pretendohet se Milan Radoičiq shfaqej në Manastirin e Banjskës së bashku me pjesëtarë të grupit të armatosur. Më 29 shtator 2023, Radoičiq pranoi hapur përgjegjësinë për organizimin e sulmit.

Tashmë në trevjetorin e ngjarjes, Radoičiq ende lëviz i lirë në territorin e Serbisë. INTERPOL-i kishte lëshuar një urdhër-arresti ndërkombëtar më 7 dhjetor 2023, ndërsa Kosova ka kërkuar gjithashtu ekstradimin e personave të tjerë të akuzuar që gjenden jashtë territorit të saj.

Më 11 shtator 2024, Prokuroria Speciale e Kosovës depozitoi aktakuzën kundër Radoičiqit dhe 44 personave të tjerë. të cilët përballen me akuza për terrorizëm. financim të terrorizmit dhe pastrim parash. Sipas dokumentit të

të fundit /



Haradinaj përkujton Afrim Bunjakun: Ironi e hidhur që agresorët...



Katër emra të rinj në ekipin e Alban Bushit për testin me Ukrainë...



Abdixhiku përkujton Afrim Bunjakun: Emër i skalitur si simbol i...



Pekini vazhdon furnizimin e Iranit me komponentë të dyfish...



Numri i të prekurve nga virusi i Nilit Perëndimor arrin 70, Shkupi më i...



Sveçla: Pa u arrestuar të gjithë terroristët, drejtësia për Afrim...



Seanca plenare, PD kërkon ndryshimin e rendit të ditës: Rama ...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

akuzës, grupi kishte për qëllim shpëputjen e veriut të Kosovës dhe aneksimin e tij me Serbinë.

Procesi gjyqësor për tre të pandehurit që ndodhen në paraburgim filloi në Gjykatën Themelore të Prishtinës një ditë pas përvjetorit të parë të ngjarjes. Ata u deklaruan të pafajshëm dhe gjykimi tashmë vijon me shqyrtimin e materialeve provuese dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Për 42 të akuzuarit e tjerë, gjykata nuk e ka lejuar zhvillimin e procesit në mungesë.

Në aktakuzë, Prokuroria pretendon se planet për sulmin kishin filluar të merrnin formë shumë më herët dhe se ishte Radoiqiq ai që kishte drejtuar, pajisur dhe financuar anëtarët e grupit. Gjithashtu, prokurorët ngrënë pretendime për mbështetje dhe përfshirje të strukturave shtetërore serbe, akuza këto që do të duhet të vërtetohen gjatë rrugës gjyqësore.

Shtuar më 24.09.2026 10:22

Tags: [dyert](#), [Familja e Afrim Bunjakut](#), [Hapje](#)



Haradinaj përkujton Afrim Bunjakun: Ironi e hidhur që agresorët qëndrojnë të lir...



Abdixhiku përkujton Afrim Bunjakun: Emër i skalitur si simbol i rezistencës së...



Sveçla: Pa u arrestuar të gjithë terroristët, drejtësia për Afrim Bunjakun mbet...



Ramadani akuzon Serbinë për organizimin dhe paralajmërimin e sulmit n...



Specialja zbut kufizimet për vizitat ndaj Hashim Thaçit



Vendimi i Hagës dhe pasojat diplomatike për Kosovën: Analistët...



Konjufca: Kosova mbështet Forcën Ndërkombëtare të Stabilizimit për Gazën dh...



Avokati i Jakup Krasniqi: Apeli pritet ta mbyllë procedurën brenda 12...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.